



Pranuar / Dorezuar Priljevend/Prodato Received/Delivety	20.06	707	3 viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS/SHCK	41918/2023		714



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.719/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.719/2023 të datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesi me adresë rr. kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "ri-sistemim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.719/2023 e datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet Vendimi Nr.544 i datës 03.05.2023 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të kthej ankuesin në pozitën e punës "Udhëheqës i zyrës së pranimi" në Qendrën e paraburgimit në Prizren sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 01.07.2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e tij e punës, si dhe të njëjtit t'i kompensoj diferencën e pagës së ndaluar nga data 03.05.2023 deri në zbatim të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 11.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4179/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.719/2023 në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.544 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës lidhur me ri sistemimin e ankuesit, me pretendimet ankimore se duke u bazuar në nenin 57 të Ligjit për Zyrtarë Publik Transferimi në rast të mbylljes apo ristrukturimit 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar, e që në këtë rast nuk ka shuarje, mbyllje e as ristrukturim të institucionit apo këtij sektori i cili është ende në funksion.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.05.2023 përmes e-mailit ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 23.05.2023 përmes e-mailit, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 4179/2023 të datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër Nr.544 i datës 03.05.2023, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; E-mail nga [] për [] i datës 28.04.2023; E-mail nga [] për [] i datës 25.04.2023; E-mail nga [] për [] i datës 25.04.2023; E-mail nga Drejtoria SHKK për [] etj. i datës 24.04.2023; Vendim me numër Nr.502 i datës 24.04.2023, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendim me numër Nr.734 i datës 04.07.2022, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendim me numër Nr.0526 i datës 11.05.2022, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendim me numër Nr.1097 i datës 31.05.2012, i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar e [] e datës 01.07.2020; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar e [] e datës 02.07.2015; Kontratë e Punësimit e Sh.K. i datës 02.07.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë viti 2021 i Sh.K. i datës 28.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë viti 2020 i [] i datës 22.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për stafin korrektues i [] i datës 13.12.2019; Formulari i vlerësimit të kryerjes së punëve e [] i datës 30.12.2016; Formulari i vlerësimit të kryerjes së punëve e [] i datës 22.12.2015; Përshkrimi i detyrave të punës; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.07.2012; Kërkesë në lidhje me koeficientin me numër protokoll 2333/18 i datës 02.10.2018; E-mail nga [] për [] i datës 30.05.2015; E-mail nga [] për [] i datës 02.10.2013; E-mail nga [] për [] etj. i datës 16.10.2012; Kërkesë me numër protokoll 0887/20 i datës 03.09.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.05.2023; Përgjigje në ankesë përmes e-mailit e datës 23.05.2023; Shkresat e lëndës me numër protokoll 717 i datës 23.05.2023; Akt Emërim i [] me numër Nr.170/2023 i datës 05.05.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 13.02.2012; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.07.2012; Vlerësimi i rezultateve në punë 2022 e Sh.K. i datës 28.01.2023; E-mail nga [] për [] i datës 19.06.2023; E-mail nga [] për [] i datës 19.06.2023; E-mail nga [] për [] i datës 16.06.2023; Lista e pagave e muajit Janar deri Maj 2023; Lista e pagave e muajit Tetor deri Dhjetor 2022; E-mail nga [] për [] i datës 19.06.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosies e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe se i njëjti sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 01.07.2020 është emëruar në pozitën e punës *"Udhëheqës i zyrës së pranimit"* në Qendrën e paraburgimit në Prizren, e të cilën pozitë ankuesi e ka ushtruar që nga data 01.07.2020 deri në nxjerrjen e Vendimit Nr.544 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të cilin vendim ankuesi është ri sistemuar nga pozita e punës *"Udhëheqës i zyrës së pranimit"* në Qendrën e paraburgimit në Prizren me koeficient 10 të pagës, në pozitën e punës *"Mbikëqyrës i lartë Grada III"* në Qendrën e paraburgimit në Prizren, me arsyetimin se pozita e *"Udhëheqësit i zyrës së pranimit"* nuk parashihet në Rregulloren QRK.Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

Kundër Vendimit Nr.544 të datës 03.05.2023 për ri sistemim, ankuesi me datë 11.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se duke u bazuar në nenin 57 të Ligjit për Zyrtarë Publik Transferimi në rast të mbylljes apo ristrukturimit 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar, e që në këtë rast nuk ka shuarje, mbyllje e as ristrukturim të institucionit apo këtij sektori i cili është ende në funksion.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.12.2013, dhe si rrjedhojë duke bazuar në nenin 97 paragrafi 1, 1.1 dhe 1.2 të kësaj rregullore përbehet nga këta sektorë: 1. Njësitë e Qendrës së Paraburgimit në Prizren janë si vijon: 1.1. Njësia për Punë Juridike dhe të Përgjithshme; 1.2. Njësia për Siguri dhe Operativë. Ndërlidhur me këtë, Kolegji bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se pozita e *"Udhëheqës i zyrës së pranimit"* në Qendrën e paraburgimit në Prizren ushtrohet nga ankuesi i emëruar nga data 01.07.2020.

Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i prova të lëndës rezulton se Shërbimi Korrektues i Kosovës me hyrjen në fuqi të Rregullores QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka bërë sistemimin e ankuesit për shkak të ristrukturimit ashtu siç përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë gjegjësisht nenin 13 të kësaj rregullore me të cilin përcaktohej se: *"Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës. 2. Në rast se paraqiten rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëpunësit civilë sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori, në njërin nga institucionet e përcaktuara në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit. 3. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar apo të shuar njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit"*, respektivisht ankuesi në pozitën e *"Udhëheqës i zyrës së pranimit"* në Qendrën e paraburgimit në Prizren, ka qenë i emëruar në këtë pozitë para hyrjes në fuqi të Rregullores QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, kështu që edhe sistemi i tyre si pasojë e ristrukturimit nuk është bërë deri me rastin e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje meritorë të kësaj çështje analizoi edhe dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës (i cili ka hyrë në fuqi me datë 24.08.2022), përkatësisht nenin 10 paragrafi 2 përcaktohet se: *2.Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i Shërbimit Korrektues të*

Kosovës, rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë sipas legjislacionit përkatës në fuqi, dhe nenin 68 të njëjtit ligj ku përcaktohet se: 1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. 2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas këtij Ligji zbatohen aktet nënligjore në fuqi, me kusht që mos të jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji, Kolegji vlerëson se ankuesi ka të drejtë t'i ushtroj detyrat e punës sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 01.07.2020, deri në nxjerrjen e akteve nënligjore siç përcaktohet me dispozitat e nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, rrjedhimisht deri në nxjerrjen e rregullores për organizim të brendshëm të SHKK dhe përfundimin e procesit të sistematizimit të vendeve të punës.


Bazuar si më sipër Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesi për shkelje të ligjit material nga organi i punësimit me rastin e ri sistemimit të tij nga pozita e punës "Udhëheqës i zyrës së pranimit" në Qendrën e paraburgimit në Prizren, me koeficient të pagës dhjetë (10), në pozitën e punës "Mbikëqyrës i lartë Grada III" në Qendrën e paraburgimit në Prizren, me koeficient të pagës nëntë (9), është i bazuar dhe i drejtë, ndërsa Vendimi Nr.544 i datës 03.05.2023 është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.719/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

